

## AKT THEMELIMI

dhe

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “J.K.B. CONSULTING” SH.P.K.

#### KAPITULLI I

#### EMRI, FORMA, BAZA LIGJORE, SELIA, TERRITORI

##### Neni 1

##### Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 1.10.2021, shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**J.K.B. CONSULTING**” Sh.p.k., e cila më poshtë do të quhet “Shoqëria”, është themeluar nga znj. Jonida Begaj Gokov lindur në Vlorë në datën 05.09.1982 me nr. personal I25905184F dhe z. Elez Imeraj lindur në Vlorë në datën 20.07.1983 nr. personal I30720105R. Në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” miratuan dhe nënshkruan këtë statut të shoqërisë “**J.K.B. CONSULTING**” shpk.

##### Neni 2

##### Forma

Kjo Shoqëri “**J.K.B. CONSULTING**” sh.p.k. është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Themeluesit e saj janë persona fizikë, që mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

##### Neni 3

##### Baza ligjore

Shoqëria është krijuar në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë konkretisht në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij Statuti.

##### Neni 4

##### Selia

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën, Rruga Sulejman Delvina, P43, Sh28, Ap. 169, Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti mund të hapë degë, filiale ose shoqëri të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj.

##### Neni 5

##### Territori

Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë dege, filiale ose përfaqësi, në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

## KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### Neni 6 Objekti

1. Konsulencë ligjore dhe juridike dhe përfaqësim para organeve të administratës publike dhe organeve gjyqësore për çështje në fushën e të drejtës civile, penale, administrative, të drejtës së shoqërive tregtare, financiare, arsimit të lartë dhe parauniversitar, trashëgimisë kulturore, artit, kulturës dhe të drejtave të autorit, pronësisë industriale, teknologjisë së informacionit, të drejtave të njeriut, të drejtës së arbitrazhit, të drejtës së konsumatorit, legjislacionit doganor, bankar, prokurimit publik dhe partneritetit publik privat, koncensioneve, sigurimeve shoqërore, kontabilitetit, kriminalistikës, legjislacionit të punës etj.
2. Hartim të akteve ligjore për shoqëritë tregtare dhe organizatat jofitimprurëse si dhe regjistrimin e tyre në QKB ose gjykatë, kryerje të veprimeve pranë organeve tatimore dhe përfaqësim ligjor për kompani shqiptare dhe të huaja. Përpilim dhe depozitim dokumentesh të shoqërive tregtare dhe organizatave jofitimprurëse të regjistruara si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj për ndryshimet e administratorëve, ortakëve, ndryshimin e kapitalit, transferimin e kuotave, ndryshim statuti, eksperti kontabël, dhe çdo procedurë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare.
3. Konsulencë dhe ekspertizë në fushën e investimeve, zhvillimit të pasurive të paluajtshme, tregjeve financiare, bursave në vend dhe jashtë saj, në fushën e tregtisë ndërkombëtare, industrisë telekomunikacionit dhe teknologjisë së informacionit, në fushën e turizmit, ndërtimit dhe inxhinierisë, në hartim projektesh etj.
4. Regjistrim markash, dizenjosh, treguesish gjeografik dhe patentash pranë autoriteteve shqiptare dhe ndërkombëtare.
5. Ndjekjen e procedurave dhe praktikave që kanë të bëjnë me lejet e qëndrimit dhe punës për të huaj si dhe çdo dokument të domosdoshëm për shtetasit dhe personat juridikë të huaj që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri.
6. Përkthim me shkrim, përkthime simultane dhe konsektive nga përkthyes të autorizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe përkthyes me eksperiencë.
7. Agjenci imobiliare, ndërmjetësim në shitblerje dhe marrje-dhënie me qira të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme brenda dhe jashtë vendit.
8. Veprimtari komisionere, ndërmjetësimi, përfaqësimi dhe konsulence.
9. Studime, analiza, publikime, projekte, trajnime. ekspertiza si dhe kërkim shkencor në fusha si edukimi, drejtësia, qeverisja, ekonomia, biznesi, bujqësia dhe zhvillimi rural, fusha sociale, sporti, turizmi, turizmi shëndetësor, inxhinieria, gjeologjia, industria, sektori automotiv etj brenda dhe jashtë Shqipërisë.
10. Çdo veprimtari tjetër konsulence dhe ekspertize brenda kufijve të parashikuar në legjislacionin në fuqi dhe aktivitete të tjera që ndihmojnë shoqërinë në rritjen e objektit të saj fitimprurës.
11. Projekte: identifikim i fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare, shkrimi i programeve dhe projekteve, menaxhimi i projekteve dhe fondeve, zbatimi i projekteve etj; Bashkëpunim me autoritetet publike dhe private vendase dhe organizma rajonale dhe ndërkombëtarë për shkëmbimin e eksperiencave dhe realizimin e projekteve me interes të përbashkët. Konsulencë në hapësirën evropiane dhe mesdhetare për mbështetjen dhe favorizimin e integritit të subjekteve shqiptare në politikat evropiane me anë të asistencës dhe zbatimit të projekteve me: Fonde

Evropiane Zhvillimi Rajonal; Fonde Sociale Evropiane; Fonde kohezioni; Fonde evropiane per bujqësinë dhe zhvillimin rural;

#### **Neni 7**

##### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj, ne statut ose me vendim të Asamblesë së përgjithshme.

### **KAPITULLI III**

#### **AUTORITETI I ASAMBLESË, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI**

#### **Neni 8**

##### **Fusha e autoritetit te Asamblesë**

Fusha e autoritetit të Asamblesë dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon Asambleja në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut dhe ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 9**

##### **Libri i Shoqërisë**

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

#### **Neni 10**

##### **Konfidencialiteti**

Personat e pranuar dhe të punësuar në Shoqëri, duhet të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka në dëm te saj.

#### **Neni 11**

##### **Dokumentet e destinuar për të tretët**

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuar për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

### **KAPITULLI IV**

#### **KAPITALI, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË**

#### **Neni 12**

##### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.  
Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët. Shoqëria mund ta shtojë ose zvogëloje kapitalin, në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj me vendim të Asamblesë së përgjithshme, si me mjete financiare ose me pasuri të paluajtshme.

### **Neni 13**

#### **Kuotat**

Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale totale 5.100 (pesemije e njeqind) lekë që zotërohet nga znj. Jonida Begaj Gokov dhe 1 (një) kuotë me vlerë nominale totale 4.900 (katërmije e nentëqind) lekë që zotërohet nga z. Elez Imeraj.

### **Neni 14**

#### **Zoterimi i kuotave**

Kuotat e shoqërisë zotërohen 51% nga ortaku znj. Jonida Begaj Gokov dhe 49% nga ortaku z. Elez Imeraj.

### **Neni 15**

#### **Mënyrat e fitimit dhe të kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe të tretëve.

Kalimi i kuotave bëhet me marrëveshje mes ortakëve themelues, në bazë të një kontrate me shkrim duke respektuar parimin e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas legjislacionit në fuqi. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

## **KAPITULLI V**

### **STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 16**

#### **Organet Drejtuese**

Si organe drejtuese të Shoqërisë janë;

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve.
2. Administratori.

### **Neni 17**

#### **Kompetencat e Asamblesë së përgjithshme**

Kompetencat e Asamblesë së përgjithshme do të jenë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 18**

#### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 14 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 19**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 20**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## Neni 21

### Përfashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 22

### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Kur asambleja emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Administratori i **“J.K.B. CONSULTING”** shpk emërohet z. **Elez Imeraj**, i biri i Bardhoshit, lindur në Vlorë në datën 20.07.1983 nr. personal I30720105R, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Specimeni i nënshkrimit të administratorit Z. Elez Imeraj:

\_\_\_\_\_ (emër, mbiemër, firmë).

## Neni 23

### Administratori dhe kompetencat e tij

Kompetencat e administratorit në mënyrë konkrete dhe të detajuara përcaktohen në aktin e tyre të emerimit.

Administratori përveç të tjerave ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. Të administrojë veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
- b. Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
- c. Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të shoqërisë, bilancin e konsoliduar dhe propozon shpërndarjen e fitimeve duke kërkuar për këto miratimin e Asamblesë së përgjithshme;
- d. Të regjistrojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);
- e. Të raportojë përpara Asamblesë së përgjithshme për realizimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- f. Të koordinojë veprimtarinë e personave të punësuar në Shoqëri;
- g. Të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me organet shtetërore dhe me personat e tretë.
- h. Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Emërimi i administratorit do të bëhet për një afat prej 5 - vjeçar me të drejtë riemërimi.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij dhe është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet që rrjedhin nga shkelja e kryer.

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave sipas standarteve të kërkuara.

Shkarkimi i tij bëhet me vendim të Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë me shumicë votash.

## Neni 24

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

## KAPITULLI VI LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET

### Neni 25

#### Librat e Shoqërisë

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakëve dhe kapitalin themeltar, vendimet e asamblesë së ortakëve, dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

#### **Neni 26**

##### **Bilanci**

Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar, raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, propozizmet për ndarjen e fitimeve nënshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

#### **Neni 27**

##### **Dividentet**

Asambleja e përgjithshme miraton llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit, përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit pasi i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme, përcakton dividendin. Asambleja e përgjithshme vendos dhe për ndarjen e dividendit.

#### **Neni 28**

##### **Marrëdhëniet e Punës**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri gjejnë rregullim në kontratën e punës, në Kodin e Punës dhe në aktet e tjera që kanë dalë në zbatim të këtij kodi.

### **KAPITULLI VII**

### **LIKUJDIMI DHE PRISHJA E SHOQËRISË**

#### **Neni 29**

##### **Mbarimi**

Shoqëria priset:

- a. me vendim të Asamblesë së përgjithshme;
- b. me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë së saj në QKB;
- d. me vendim të gjykatës.

Në të gjitha rastet administratori duhet të rregjistrojë prishjen e shoqërisë në QKB në përputhje me nenet 43 dhe 45 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit"

#### **Neni 30**

##### **Likujdimi i shoqërisë**

Prishja e shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese bëhet me procedurën e likujdimit të shoqërisë kur nuk është nisur procedurë falimentimi.

Ky fakt rregjistrohet në QKR, duke shtuar tek emri i shoqërisë shenimin "në likujdim".

Për të ndjekur procedurën e likujdimit Asambleja e përgjithshme emëron një likujdues.

Nëse shoqëria priset me vendim gjykate, likujduesi emërohet nga Gjykata.

Shkarkimi i likujduesit bëhet me të njëjtën mënyrë siç bëhet dhe emërimi i tyre.

Në rast prishje shoqëria do të përpiqet të aplikojë likujdimin e thjeshtëzuar në përputhje me dispozitat e neneve 204 dhe 206 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"



**KAPITULLI VIII**  
**MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 31**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit Asambleja e përgjithshme dhe administratori do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim dhe nëse kjo nuk arrihet, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 32**

**Dispozita te fundit**

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Shoqëri Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë. Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës përcaktohen nga Asambleja e përgjithshme Ky Statut përmban 10 (dhjetë) faqe dhe është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale, në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore.

**ORTAKËT**

**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**Jonida Begaj Gokov**

Jonida Begaj Gokov

(emër, mbiemër, firmë)



**Elez Imeraj**

ELEZ IMERAJ

(emër, mbiemër, firmë)

